

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vuçiç tërbohet me Nik Gjeloshajn që tha se “çdo shqiptar mban në zemër luftën e shenjtë të UÇK-së”: A do të ndalet integrimi i Malit të Zi në BE??
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/vucic-terbohet-me-nik-gjeloshajn-qe-tha-se-cdo-shqiptar-mban-ne-zemer-luf-i586558
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 18:59:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 18:52:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c9f753ddfd967c27c2db45542c799f71992a98a22820665d590c41281f59b05c
TEKSTI	506ecd2efc6221a954be9109a158112c1c374221ffb7cd69855a7c7980706da2
PAMJA	4f79112d365d2abdfa3022f98a1f32a1ef5b50c0ada8a718ad64add12338dafd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b41486cd500f94ed5b3db3c4c8f7ccc1d04cc7617a5d79005596ada8fe784591
E MËPARSHMJA	02dcda4a1abf1934e6244abee98ccc3af0aeeb8b6dd343ef444adc87ef110f1a
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b41486cd500f94ed5b3db3c4c8f7ccc1d04cc7617a5d79005596ada8fe784591>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



le Rriten tensionet Turqi-Greqi, Ankaraja zhvendos nje brigade me 2000 komando perballe Samosit! Mediat e lidhin me viziten e MitsotakisDroni rus i zbuluar ne Detin Ball fundit

Vuçiç tërbohët me Nik Gjeloshajn që tha se “çdo shqiptar mban në zemër luftën e shenjtë të UÇK-së”: A do të ndalet integrimi i Malit të Zi në BE??



16 Shtator 2026, 20:52Rajoni TEMA



Dënimi skandaloz i ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Hagë ka nxjerrë reagime të forta politike në të gjithë rajonin, ndërsa ka nxjerrë sërish në pah retorikën agresive të presidentit serb, Aleksandar Vuçiç. I përballur me një qëndrim të palëkundur kombëtar nga zëvendëskryeministri i Malit të Zi, kryetari i Forumit Shqiptar, Nik Gjeloshaj, i cili deklaroi hapur se lufta e UÇK-së ishte çlirimtare dhe se çdo shqiptar e mban në zemër këtë përpjekje të shenjtë, Vuçiç është tërbuar publikisht gjatë një konference për media në Beograd.

I papërmbytur nga kjo deklaratë, Vuçiç pyeti publikisht dhe me ironi nëse Perëndimi do t'i bllokojë integrimet evropiane të Malit të Zi, duke pretenduar se qëndrimi të tilla mohojnë sundimin e ligjit.

Sulmi i hapur i presidentit serb ndaj Gjeloshajt vjen pikërisht në momentin kur komandantët e UÇK-së u dënuan në Hagë. Kjo orvatje e radhës e Beogradit duket se përshtatet me një plan më të gjerë strategjik për të goditur, tkurrur dhe dobësuar faktorin shqiptar në rajon, e në mënyrë të veçantë në Malin e Zi, ku prania dhe roli i shqiptarëve mbeten kyç për stabilitetin dhe orientimin euroatlantik.

Më poshtë vijon artikulli i plotë i publikuar nga media malazeze Vijesti:

Artikulli i transmetuar nga “Vijesti”:

Vuçiç: A do t'i ndalin integrimet evropiane të Malit të Zi për shkak të deklaratës së Gjelošajt?

“Njëri që guxoi të thoshte se i ka shprehur ngushëllime dikujt, tani nuk guxon as të shikojë lart, e lëre më diçka tjetër në Malin e Zi,” tha presidenti i Serbisë.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, ka pyetur se a do të ndalen integrimet evropiane të Malit të Zi pas deklaratës së zëvendëskryeministrit të Malit të Zi, Nik Gjeloshaj, se “çdo shqiptar mban në zemër luftën e shenjtë” të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë dënuan sot në shkallë të parë ish-drejtuesit e UÇK-së, Hashim Thaçin dhe Jakup Krasniqin me nga 25 vjet burgim, ndërsa Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin me 18, përkatësisht 13 vjet burgim, për krime me prapavijë luftime në Kosovë dhe Shqipëri gjatë viteve 1998 dhe 1999.

”Njëri që guxoi të thoshte se i ka shprehur ngushëllime dikujt, e që më nuk guxon as të shikojë lart, e lëre më diçka tjetër në Malin e Zi, sot iu desh të dëgjonte — dhe të gjithë ne u deshtë të dëgjoni — nga ministri malazez Gjelošaj, i cili thotë: ‘Çdo shqiptar mban në zemër luftën e shenjtë të UÇK-së’. A do t’i ndalin për këtë shkak integritet evropiane, pasi po pështynë mbi aktgjykimin dhe po mohojnë sundimin e ligjit, apo kjo vlen vetëm për serbët? Ata thonë: ‘Kurrë nuk kam besuar se një vendim gjyqësor mund të jetë kaq i padrejtë. Lufta e UÇK-së ishte çlirimtare’, porosit zëvendëskryeministri i Malit të Zi për politikë ekonomike dhe ministri i zhvillimit ekonomik,” deklaroi Vuçiq në një konferencë për media në ndërtesën e Presidencës së Serbisë në Beograd.

Kryetari i Kuvendit të Malit të Zi, Andrija Mandiq, së fundmi tha se i kishte shprehur ngushëllime familjes së Ratko Mlladiqit me rastin e vdekjes së ish-komandantit të luftës të Ushtrisë së Republikës Srpska. Pas kësaj, Partia Demokratike e Socialistëve (DPS) në opozitë paraqiti iniciativën për shkarkimin e Mandiqit, për të cilën deputetët duhet të deklarohen në seancën e 24 shtatorit. Tribunali i Hagës e kishte shpallur Mlladiqin fajtor për gjenocid në Srebrenicë, krime kundër njerëzimit dhe shkelje të ligjeve e zakoneve të luftës në Bosnjë e Hercegovinë.

Vuçiq, duke komentuar edhe deklaratat e zyrtarëve të tjerë nga rajoni, tha se mund të shihet “se sa standarde double, gënjeshtra dhe mungesë parimesh ka në rrethim.”

<https://www.vijesti.me/vijesti/politika/827015/vucic-hoce-li-zaustaviti-evropske-integracije-crne-gore-zbog-izjave-djeljosaja>

Reagimi i Gjelošajt për komandantët:

Lajm shumë i keq dhe një vendim jashtëzakonisht i padrejtë!

Sot mund të jetë ditë zie për shqiptarët, por qëndrimi dinjitoz i të akuzuarve i jep forcë popullit shqiptar që ta përballojë këtë dhimbje, me besimin se ky aktgjykim i tmerrshëm do të rrëzohet në instancat më të larta.

Nuk kam besuar kurrë se një vendim gjyqësor mund të ishte i tillë dhe kaq i padrejtë. Ky është vendim i shkallës së parë dhe procesi gjyqësor nuk ka përfunduar. Besojmë se, deri në përfundimin e plotë të procesit, do të dëshmohet pafajësia e të gjithëve.

Lufta e UÇK-së ishte vetëmbrojtëse, çlirimtare dhe e drejtë. Ishte luftë për mbijetesën, lirinë dhe shtetin e Kosovës, e përkrahur nga aleatët tanë perëndimorë. Agresori nuk mund dhe nuk duhet të barazohet me atë që është detyruar të mbrohet.

Shqiptarët dhe vetë të akuzuarit i kanë respektuar institucionet ndërkombëtare. Ata as nuk kanë ikur, as nuk janë fshehur, por janë paraqitur para drejtësisë dhe do ta vazhdojnë betejën e tyre ligjore deri në fund.

Çdo shqiptar e ka në zemër luftën e shenjtë të UÇK-së dhe komandantin legjendar Adem Jashari. Çdo shqiptar beson në pafajësinë e tyre!

Liria dhe pavarësia kanë një vullë: UÇK-ja dhe Amerika!

P.S.
Nuk ia vlen të komentohet nxjerrja e një deklaratë sime nga konteksti dhe manipulimi me të. Biseda ishte për respektimin e vendimeve të gjykatave ndërkombëtare nga shqiptarët, për dallim nga qëndrimi i palës tjetër.

Kurrë nuk kam besuar se gjykatat ndërkombëtare mund të bëjnë padrejtësi. Edhe Ante Gotovina përjetoi padrejtësi në shkallën e parë, por në shkallën e dytë fitoi drejtësi.

Besojmë deri në fund; beteja për drejtësi vazhdon!

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Shtohen zërat për shpërbërjen e Speciales, Këshilli Shqiptaro-Amerikan dënon vendimin për 4 ish-krerët e UÇK](#)

20:50 Rajoni

“Asnjë gjyqtar nga Haga nuk i përket Kosovës” - Dënimi i ish-liderëve të UÇK, reagon Meidani: Konteksti historik s’d

20:20 Rajoni

Protestuesit gjuajnë me gurë godinën qeveritare në Prishtinë, arrestohet një prej tyre. Tubim edhe para Parlamentit

20:15 Rajoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.